



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 17.04.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve dhe Përfundimit nr.06-23138-13/2 të miratuar me dt: 25.03.2015 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, me të cilin është miratuar kërkesa e Shoqatës së Familjarëve të Dëshmoreve dega në Gjakovë për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve operative të kësaj shoqate, me dt: 17.04.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e Shoqatës së Familjarëve të Dëshmoreve dega në Gjakovë, e evidentuar me nr. 01-400-7932 e dt: 28.01.2015, për mbështetje financiare të kësaj shoqate për mbulimin e shpenzimeve operative për periodën një vjeçare, duke e mbështetur me subvencione të Drejtorisë për Arsim në vlerë prej 1,800.00€.

II. Autorizohet Drejtorja për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,800.00€ nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Arsim dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e Shoqatës së Familjarëve të Dëshmoreve dega në Gjakovë, nr. 1704-0016-000039.09 Banka NLB.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

IV. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Arsim
- Z. Masar Binxhia, kryetar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmoreve - dega në Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila